



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

RAPORT

PËR INSPEKTIMIN NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË
NË ADMINISTRIMIN E SHËRBIMIT CIVIL

KËSHILLI I QARKUT ELBASAN

Tiranë, Korrik 2015

RAPORT

Për kryerjen e inspektimit të përgjithshëm pranë institucionit, Këshilli i Qarkut Elbasan.

Hyrje

Në mbështjete të nenit 11, pika 1, si dhe të nenit 14, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, me Vendimin nr. 39, datë 23.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Elbasan”, vendosa kryerjen e inspektimit të përgjithshëm në këtë institucion për verifikimin e ligjshmërisë në gjithë institutet e ligjit, duke nisur nga kuptimi dhe zbatimi i drejtë i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; plotësimi i kushteve ligjore të statusit të punësimit, të parashikuara në nenin 67 të ligjit të sipërcituar; lëvizja, transferimi apo lirimi nga shërbimi civil i punonjësve, nëse këto procedura janë bërë sipas parashikimeve të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”; përputhja e përkrahjeve të reja të punës me modelin e parashikuar nga ligji; plotësimi i kërkesave të përgjithshme e të veçanta të pozicioneve të punës nga punonjësit e mbajtur pas ristrukturimit, etj.

Në zbatim të Vendimit nr. 39, datë 23.04.2015, “Për kryerjen e inspektimit në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil si dhe në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Elbasan”, grupi i inspektimit, i përbërë nga Zamira Mujali dhe Ilirjan Osmanlliu, në datën 12.05.2015, kontaktoi personalisht me personin e kontaktit, *****, me detyrë Drejtor i Burimeve Njerëzore, si dhe me Kryetarin e Këshillit të Qarkut Elbasan, *****.

Qëllimi i inspektimit:

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paralajmërimi i institucionit dhe personave përgjegjës, në rast të konstatimit të parregullsive gjatë zbatimit të ligjit, duke lënë detyrat dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Objekti i inspektimit

1. Si janë kuptuar e zbatuar dispozitat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të tij, në lidhje me procesin e ristrukturimit (neni 50 i ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”).

2. Kontrolli i procesit të ristrukturimit të institucionit, Këshilli i Qarkut Vlorë (zbatimi i kërkesave të nenit 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij), në lidhje me mënyrën e zbatimit të kërkesave të ligjit në fjalë, që nga krijimi i komisionit të ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në pozicionet e lira ekzistuese, në rastin kur nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme, deri në daljen e vendimit përfundimtar të transferimit, i cili është kompetencë e njësisë së personelit.

3. Rregullimin e ligjshmërisë në procesin e ristrukturimit nëse vërehen shkelje të procedurës dhe kushteve të përcaktuara në nenin 50, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar me ligjin nr. 178/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit.

4. Plotësimi i kushteve ligjore të parashikuara në nenin 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me statusin e punonjësve dhe nëpunësve aktualë, që do të verifikohet në këto aspekte:

- Përfshirja e funksionit në shërbimin civil në përputhje me përshkrimin e punës dhe detyrat që realizon ky funksion;
- Punonjësit ekzistues që janë punësuar në pozicione të shërbimit civil sipas këtij ligji, që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, nëpërmjet procedurave të ngjashme me dispozitat e ligjit të mëparshëm nr.8549, dt.11.11.1999, “Statusi nëpunësit civil”, apo për një periudhë më të vogël se 1 (një) vit;
- Nëpunës ekzistues që janë të punësuar në pozicione pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji, pa kaluar më parë në procedurë formale konkurruese ose që kanë më pak se 1 (një) vit në këto pozicione pune;
- Rastet e refuzimit të deklaramit të statusit të nëpunësit civil;
- Si është dokumentuar procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, në rastin e deklaramit të statusit të punësimit të punonjësve.

Metodologjia e inspektimit

Inspektimi përfshiu verifikimin e procesit të ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Elbasan, praktikën e lirim nga shërbimi civil të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës apo u janë ndryshuar kërkesat e posaçme dhe të përgjithshme, për shkak të ristrukturimit

të institucionit bazuar në Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015”.

Me shkresën Nr. 335, datë 23.04.2015, u njoftua institucioni, Këshilli i Qarkut Elbasan, në lidhje me fillimin e inspektimit dhe objektin e tij.

Grupi i punës, në datë 12.05.2015, kontaktoi personalisht me personin e kontaktit, *****, Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse. Nga ana e tij u vu në dispozicion dokumentacioni i kërkuar, në bazë të të cilit u përgatit materiali në vijim, sipas objektit dhe qëllimit të inspektimit.

Në zbatim të programit dhe drejtimit të inspektimit të përcaktuar në Vendimin nr. 39, datë 23.04.2015, u verifikua dhe u trajtua dokumentacioni i mëposhtëm në raport me procedurat ligjore:

- Vendimi nr.29, datë 30.01.2015, i Këshillit të Qarkut Elbasan, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015”.
- Vendimi nr.23, datë 24.01.2014, i Këshillit të Qarkut Elbasan, “Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan, për vitin 2014”.
- U shqyrtuan aktet e deklarimit të statusit për të gjithë nëpunësit e Këshillit të Qarkut Elbasan, të lëshuara nga Njësia e Personelit.
- Formularët e përshkrimit të punës për të gjithë pozicionet e shërbimit civil sipas strukturës aktuale të vitit 2015.
- Listëpagesat e muajit prill 2015 të të gjithë punonjësve të institucionit.
- Vendimet e lirimit nga shërbimi civil për shkak të ristrukturimit të ish nëpunësve civilë të Këshillit të Qarkut Elbasan.
- Urdhri nr.144, datë 31.12.2014, i Kryetarit të Këshillit të Qarkut Elbasan, “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit”.
- Urdhrat e emërimit të nëpunësve civilë pas ristrukturimit të institucionit.
- Procesverbali i Komisionit të Ristrukturimit nr.1926/2, datë 31.01.2015, në lidhje me lirimin nga shërbimi civil.

Përmbajtja e raportit:

I. Procesi i deklarimit të statusit të punësimit dhe plotësimi i kushteve ligjore për të deklaruar statusin e punësimit, në përputhje me kërkesat e nenit 67 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

1. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e inspektimit .

Ligji nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, vendos rregulla të qarta për mënyrën e administrimit të shërbimit civil, për të gjitha institucionet që hyjnë në fushën e veprimit të tij.

Në nenin 2 të këtij ligji përcaktohet se ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Këshilli i Qarkut është krijuar dhe funksionon si organ përfaqësues i Qarkut Elbasan, mbi bazën e ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ndryshuar me ligjin nr. 9208, datë 18.03.2004, i cili në nenet 5 dhe 6 të tij, e përcakton atë si njësi të qeverisjes vendore që përfshihet në fushën e shërbimit civil.

Administrata e Këshillit të Qarkut funksionon mbi bazën e strukturës organizative të miratuar nga Këshilli i Qarkut, sipas parashikimeve të nenit 54, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në të cilin përcaktohen detyrat dhe kompetencat e Këshillit të Qarkut.

Aktualisht, subjekti i inspektimit funksionon sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 29, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015”, ndërsa në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Këshilli i Qarkut Elbasan ka funksionuar sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr. 23, datë 24.01.2014, “Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan, për vitin 2014”.

Struktura organizative e administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, datë 26.02.2014.

Sipas strukturës organizative të miratuar me Vendimin nr.23, datë 24.01.2014 “Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan, për vitin 2014”, administrata e Këshillit të Qarkut Elbasan kishte gjithsej **78** pozicione pune. Duke patur parasysh klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, rezulton se në këtë institucion ishin **64** pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të cilat ndahen në këto kategori:

- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **4** (katër) pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme”, kategoria II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të mesëm drejtues - **9** (nëntë) pozicione pune, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”, kategoria II-b;
- Nëpunës civilë të nivelit të ulët drejtues - **2** (dy) pozicione pune, që i përket pozicionit “shef sektori-kryeinspektor”, kategoria III-b;
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **49** (dyzetnëntë) pozicione pune, që i përkasin pozicionit “specialist”, kategoria III-b dhe IV-a.

2. Si është kuptuar dhe zbatuar neni 67 i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Nisur nga fakti që Këshilli i Qarkut Elbasan është pjesë e shërbimit civil, deklarimi si nëpunës civilë ekzistues për çdo punonjës të këtij institucioni duhet të bëhet në respektim të kërkesave të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, neni 67, pikat 3, 4 dhe 6, ku përcaktohet se:

- *pika 3, “Nëpunësit civilë ekzistues, punonjësit ekzistues, që janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që janë rekrutuar sipas një procedure pranimit konkurruese, të ngjashme me atë të përcaktuar nga ligji nr.8549, datë 11.11.1999 “Statusi nëpunësit civil”, apo që janë të punësuar në të njëjtin vend pune për një periudhë jo më të vogël se 1 vit, janë, për shkak të ligjit, nëpunës civilë”;*
- *pika 4, “Nëpunës ekzistues, që janë të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, sipas këtij ligji dhe që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në pikën 3 të këtij neni, janë nëpunës civilë në periudhë prove dhe për ta zbatohen dispozitat e nenit 24 të këtij ligji. Periudha e provës fillon nga fillimi i shtrirjes së efekteve të këtij ligji”;*
- *pika 6, “Deklarimi i statusit të punësimit, sipas pikave 1, 3 dhe 4 të këtij neni, bëhet nga njësia përgjegjëse pas verifikimit të procedurës së punësimit”.*

Po kështu, në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, pika 1, është përcaktuar se: “Nëpunës civilë”, sipas pikës 3 të nenit 67, janë të gjithë ata nëpunës që kryejnë funksione të shërbimit civil në momentin e fillimit të efekteve të ligjit nr.152/2013 dhe që janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar nga ligji nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”.

Këto janë dispozitat bazë që duhet të mbante parasysh njësia përgjegjëse për të realizuar drejt detyrimin ligjor të deklarimit të statusit të punësimit.

Për të arritur në një konkluzion të saktë lidhur me veprimet e kryera nga njësia e burimeve njerëzore, si njësia përgjegjëse për administrimin e shërbimit civil, nëse veprimet e saj janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, u analizuan materialet shkresore që përmbajnë të dhëna lidhur me pozicionet pjesë e shërbimit civil, si: organigrama dhe struktura e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit, si dhe Vendimi nr.23, datë 24.01.2014, “Për miratimin e strukturës të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan, për vitin 2014”.

Në përfundim të kësaj analize, statusin e punësimit të punonjësve të këtij institucioni sipas strukturës që ka qenë në fuqi në momentin e shtrirjes së efekteve të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, datë 26.02.2014, mund ta kategorizojmë në këtë mënyrë:

a. Nëpunës, të cilët janë rekrutuar sipas procedurave konkurruese, përcaktuar në ligjin nr. 8549/1999, “Statusi i nëpunësit civil”.

Nga analiza e dokumentacionit të administruar, rezulton se nga të gjithë punonjësit e punësuar në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, **38** (tridhjetetë) punonjës janë

punësuar në respektim të kërkesave të nenit 13 e vijues të ligjit nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", me procedura konkurimi.

Nga këqyrja e akteve të administruara dhe përmbajtja e tyre rezulton se janë respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga ky ligj. Kështu, është shpallur pozicioni i lirë, është krijuar komiteti *ad-hoc*, ka dalë akti i përzgjedhjes dhe i emërimit, si dhe akti i konfirmimit si nëpunës civilë për **38** (tridhjetetë) punonjësit, sipas përcaktimeve të nenit 13 dhe 14 të ligjit nr.8549/1999, "Statusi nëpunësit civil".

b. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohëshme emërimi para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013 " Për nëpunësin civil ", i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **21** (njëzetnjë) pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 13 të ligjit nr. 8549/1999, "Statusi nëpunësit civil", para hyrjes në fuqi të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

c. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi, jo sipas përcaktimeve të nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, pas hyrjes në fuqi të ligjit të mësipërm, datë 26.02.2014.

Konkretisht, **5** (pesë) pozicionet e punës të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm në kundërshtim me nenin 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave, janë:

- Drejtor i Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave
- Specialist për emergjencat në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave
- Specialist i mjedisit në Drejtorinë e Koordinimit, Zbatimit të Strategjive Rajonale
- Specialist në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë
- Specialist-inspektor në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës

Konkluzion: Punonjësit të emëruar në pozicionet e mësipërme të punës në kundërshtim me përcaktimet e nenit 22 e vijues të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar dhe Vendimit nr.143, datë 12.03.2014, "Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese", të Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, nuk u është deklaruar statusi i punësimit nga ana e njësisë përgjegjëse të Këshillit të Qarkut Elbasan.

d. Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, që janë konstatuar të paplotësuara para momentit të deklarimit të statusit të punësimit të punonjësit të Këshillit të Qarkut Elbasan, për shkak të dorëheqjes të Drejtorit të Drejtorisë Juridike dhe specialistit të

projekteve në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, bazuar në nenin 64 dhe 66 "dh" të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"; Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe specialistit të mjedisit në Drejtorinë e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale, për shkak të plotësimit të moshës së pensionit të plotë të pleqërisë, bazuar në nenin 65, "c" të ligjit të sipërcituar.

Përpara momentit të deklarimit të statusit të punësimit, për të gjithë nëpunësit civilë të Këshillit të Qarkut Elbasan, konstatohen se janë të paplotësuar katër pozicione pune pjesë e shërbimit civil. Konkretisht:

- pozicioni i Drejtorit të Shërbimeve Juridike, funksion i cili ushtrohej nga nëpunësja civile *****;
- pozicioni i Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, i cili ushtrohej nga nëpunësi civil *****;
- pozicioni i specialistit të mjedisit në Drejtorinë e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale, funksion i cili ushtrohej nga nëpunësi civil *****;
- pozicioni i specialistes për projektet në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit, funksion i cili ushtrohej nga punonjësja *****.

***** ka filluar punë sipas përcaktimeve të nenit 13 e vijues të ligjit nr. 8549/1999, "Statusi nëpunësit civil", me aktin administrativ nr.50, datë 09.09.2011 dhe është konfirmuar si nëpunëse civile sipas përcaktimeve të nenit 14/2 të ligjit të sipërcituar në datë 10.09.2012 (nëpunës civil ekzistues). Nëpunësja ka paraqitur dorëheqjen me shkrim te njësia e burimeve njerëzore në datë 10.04.2014 dhe kjo e fundit me Urdhrin nr.71, datë 12.05.2014, ka vendosur lirim e saj nga shërbimi civil. Pozicioni i punës Drejtor i Shërbimeve Juridike ka qenë i paplotësuar deri në daljen e Vendimin nr. 29, datë 30.01.2015, "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015".

***** ka filluar punë sipas përcaktimeve të nenit 13 e vijues të ligjit nr. 8549/1999, "Statusi nëpunësit civil", me aktin administrativ nr.5, datë 16.02.2001 dhe është konfirmuar si nëpunëse civile sipas përcaktimeve të nenit 14/2 të ligjit të sipërcituar në datë 18.02.2002 (nëpunës civil ekzistues). Nëpunësja ka paraqitur dorëheqjen me shkrim te njësia e burimeve njerëzore në datë 20.05.2014 dhe kjo e fundit me Urdhrin nr.81, datë 25.05.2014, ka vendosur lirim e saj nga shërbimi civil. Pozicioni i punës specialist për projektet në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit ka qenë i paplotësuar deri në daljen e Vendimin nr. 29, datë 30.01.2015, "Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015 "Ristrukturim".

Konkluzion: Procedura e ndjekur nga ana e njësisë përgjegjëse është bërë sipas përcaktimeve të nenit 64 dhe 66 "dh" të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil".

***** ka kryer detyrën e Drejtorit të Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (nëpunës civil ekzistues). Nëpunësi është i ditëlindjes 15.05.1949 dhe njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr.93, datë 01.06.2014, ka vendosur në përputhje me nenin 65 pika 1/"c", të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë. Ky pozicion rezultoi si i paplotësuar deri në momentin e

hyrjes në fuqi të Vendimit nr. 29, datë 30.01.2015, “Për miratimin e strukturës organizative të administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015”.

***** ka filluar punë sipas përcaktimeve të nenit 13 e vijues të ligjit nr.8549/1999, ”Statusi nëpunësit civil”, me aktin administrativ nr.36, datë 08.09.2003 dhe është konfirmuar si nëpunës civil sipas përcaktimeve të nenit 14/2 të ligjit të sipërcituar në datë 08.09.2004 (nëpunës civil ekzistues). Nëpunësja është e ditëlindjes 28.05.1954 dhe njësia përgjegjëse, me aktin administrativ nr. 85, datë 02.06.2014, ka vendosur në përputhje me nenin 65 pika 1/“c”, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë. Ky pozicion më pas është shpallur si i lirë dhe është plotësuar nëpërmjet procedurës së konkurimit, parashikuar nga neni 22 e vijues i ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimi nr.143, datë 12.03.2014, ”Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave. Për procedurën e këtij konkurimi do të flasim më konkretisht në vazhdim të raportit.

Konkluzion: Procedura e ndjekur nga ana e njësisë përgjegjëse për përfundimin e marrëdhënies në shërbimin civil, për shkak të plotësimit të moshës për pensionin e plotë të pleqërisë për nëpunësit ***** dhe *****, është bërë sipas përcaktimeve të nenit 65, pika 1, germa c, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”.

- *Procedura ligjore e ndjekur në konkurimin e zhvilluar për pozicionin “specialist mjedisi”, në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në Këshillin e Qarkut Elbasan.*

Në strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Elbasan të miratuar me vendimin nr.23, datë 28.01.2014, të titullarit të institucionit, pozicioni i *specialistit të mjedisit* në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, rezultonte i paplotësuar për shkak të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil (*plotësimi i moshës për pension të plotë pleqërie*) të nëpunëses civile *****, e cila ushtronte këtë detyrë. Njësia përgjegjëse ka shpallur të lirë këtë pozicion pune dhe menjëherë ka filluar procedurat ligjore të parashikuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, për plotësimin e tij. Konkretisht:

me aktin administrativ nr.1563, datë 21.10.2014, bazuar në nenet 22 dhe 25 të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu II, IV dhe VI “Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori”, Këshilli i Qarkut Elbasan (njësia përgjegjëse) ka shpallur procedurën e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive për grupin e pozicioneve të posaçme “*specialist*” në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit në portalin “*Shërbimi Kombëtar i Punësimit*”. Shpallja ka qenë e hapur për të gjithë nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në të gjitha institucionet pjesë e shërbimit civil për procedurën e lëvizjes paralele dhe, nëqoftëse në përfundim të

procedurës pozioni rezulton vakant, ai është i vlefshëm për konkurim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Po kështu, me shkresën 1563/1, datë 21.10.2014, janë shpallur kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme për pozicionin e punës, afati i paraqitjes së dokumentacionit, si dhe është bërë e ditur mënyra e procedimit për të dyja fazat e konkurimit, si në lidhje me fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista, ashtu edhe me mënyrën e vlerësimit të kandidatëve deri në datën e daljes së rezultateve të konkurimit. Për këtë qëllim, nga ana e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, me shkresën nr.Ekstra, datë 11.12.2014, është përgatitur formulari i vlerësimit të dokumenteve për rekrutim; formulari i vlerësimit të testimit me shkrim; formulari i vlerësimit të testimit me gojë dhe në datë 16.12.2014 është bërë vlerësimi i përgjithshëm i kandidatëve. Me shkresën e datës 17.12.2014, Komisioni i Përhershëm i Pranimit ka shpallur listën e kandidatëve fitues dhe ia ka njoftuar vendimin e përzgjedhjes njësisë përgjegjëse. Kjo e fundit ka nxjerrë aktin e emërimit nr. 140, datë 22.12.2014. Me shkresën nr.1858 datë 17.12.2014, lista e fituesve është shpallur në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, sipas përcaktimeve të pikës 17, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, “Konkurimi”.

Konkluzion: Nisur nga gjithë sa më sipër, vlerësoj se, procedura e konkurimit është kryer në përputhje me nenin 22 dhe 25 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreut II, IV dhe VI “Lëvizja paralele brenda së njëjtës kategori”. Konsiderohet si parregullsi që nuk ka ndikuar në procesin e konkurimit fakti që, kandidatit fitues nuk i është marrë miratimi zyrtar, përpara se njësia përgjegjëse të nxirrte aktin e emërimit sipas përcaktimeve të pikës 22, të Vendimit nr. 143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, “Konkurimi”.

dh. Aktet e çertifikimit të statusit sipas përcaktimeve të pikave 3, 4 dhe 6, të ligjit nr.152/2013, ”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar.

Duke u nisur nga përmbajtja e pikave 3 dhe 4, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nga këqyrja e akteve, rezulton se:

- Në **48** raste nëpunësit civilë, kanë një periudhë më tepër se një vit në atë pozicion pune. Nisur nga kjo, Drejtoria e Burimeve Njerëzore sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklaramit të statusit të punësimit si nëpunës civilë për të gjitha këto raste.

Punonjësit që kanë përfutuar statusin e nëpunësit civil në këtë kategori janë:

Drejtor i Përgjithshëm i Koordinimit dhe Hartimit të Projekteve;

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më shumë se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë.

- Në 2 raste, nëpunësit ekzistues, janë punësuar në pozicione pjesë të shërbimit civil, por nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 67, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, sepse kanë një periudhë më pak se një vit në atë pozicion pune. Drejtoria e Burimeve Njerëzore, sipas përcaktimeve të nenit 67, pika 4, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit si nëpunës civilë në periudhë prove, për këto raste.

Punonjësit që kanë përfituar statusin e nëpunësit civil në periudhë prove në këtë kategori janë:

***** Specialiste për shërbimet sociale në Drejtorinë e Përkujdesit Social;
***** Specialist për shërbimet sociale në Drejtorinë e Përkujdesit Social.

Nga përmbajtja e akteve të emërimit, ku përfshihet momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës dhe atyre financiare, rezulton se këta punonjës kanë më pak se një vit që e kryejnë detyrën e tyre funksionale në pozicionet në të cilat janë deklaruar si nëpunës civilë në periudhë prove.

Konkluzion: Vlerësoj se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve të pikave 3, 4 dhe 6, të nenit 67, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe pikës 1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, Kreu II, “Statusi i nëpunësve të tjerë civilë në institucionet e administratës shtetërore, institucionet e pavarura, bashkitë dhe qarqet”, kur ka nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për këto raste.

Për këto arsye, çmoj se Drejtoria e Burimeve Njerëzore ka vepruar në përputhje me ligjin në lidhje me deklarimin e statusit të punësimit, për këto kategori punonjësish.

- *Mosdeklarimi i statusit të punësimit të punonjësve të cilët janë në pozicione pune që përfshihen në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil, por që nuk plotësojnë kriteret e posaçme për pozicionin e punës.*

Në 5 raste nëpunësve ekzistues që ushtrojnë funksione në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil u është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit nga ana e njësisë përgjegjëse, për shkak të mosplotësimit të kriterëve të posaçme (*kriteri arsimor, arsimi i mesëm*). Njësi përgjegjëse, në nxjerrjen e këtyre akteve administrative, i është referuar nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; LIDHJA 2 “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”.

Konkretisht, punonjësit që u është refuzuar deklarimi i statusit të punësimit janë:

- ***** Specialist-topograf në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve;
- ***** Specialist informacioni në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit;
- ***** Specialist i infrastrukturës rrugore në Dr.Shërbim.Rajonale;
- ***** Specialiste e marrëdhënieve me publikun në Dr.Burimeve Njerëzore;
- ***** Specialiste arkivi në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore.

Konkluzion : Vlerësoj se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, si njësi përgjegjëse, e ngarkuar nga ligji për të formalizuar aktin e deklarimit të statusit, ka vepruar sipas përcaktimeve të neneve 19 dhe 66, gërma ë, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; LIDHJES 2, “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”, kur ka nxjerrë aktin për lirim nga shërbimi civil për shkak të mosdeklarimit të statusit të punësimit për këto raste. Punonjësit e sipërcituar nuk plotësojnë kërkesën e posaçme për formimin arsimor. Të gjithë janë me arsim të mesëm, çka bie ndesh me përcaktimet e nenit 19, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe të pavarura”, të Këshillit të Ministrave; LIDHJA 2, “Përshkrimi i përgjithëm i punës për çdo kategori dhe klasë”.

- Pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të plotësuara me akte të përkohshme emërimi pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Nga analiza e materialeve të verifikuara, rezulton se **5** pozicione pune pjesë e shërbimit civil në këtë institucion janë plotësuar me akt emërimi të përkohshëm sipas dispozitave të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, duke mos respektuar procedurat e parashikuara në nenin 22 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”.

Konkretisht, pozicionet e punës të plotësuara me akte emërimi të përkohshëm janë:

- ***** , Specialist për emergjencat në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale;
- ***** , Specialist për mjedisin në Drejtorinë e Koordinimit të Strategjive Rajonale;
- ***** , Specialist inxhinier në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike;
- ***** , Specialiste për sektorin e njësisve vartëse në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale;
- ***** , Specialist në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës.

Konkluzion : Vlerësoj se, Drejtoria e Burimeve Njerëzore nuk ka vepruar në përputhje me nenin 22, të ligjit 152/2013, “Për shërbimin civil”, të ndryshuar dhe Vendimin nr.143, datë 12.03.2014, “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të

lëvizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët dhe të mesme drejtuese”, kur ka plotësuar pozicionet e mësipërme me akte emërimi të përkohshme. Njësisë përgjegjëse, pavarësisht kësaj, ka reflektuar ndaj kësaj parregullsie duke mos deklaruar statusin e punësimit për këto punonjës dhe duke ndërprerë marrëdhënien e punës si të lidhur jo sipas përcaktimeve ligjore të dispozitave të sipërcituara.

II. Procesi i ristrukturimit i Këshillit të Qarkut Elbasan

Kriteret bazë mbi të cilat është bërë vlerësimi i ligjshmërisë së procesit të ristrukturimit nga ana e njësisë përgjegjëse (*aktet e lirimt të nëpunësve që u është shkurtuar pozicioni i punës dhe aktet e riemërimit të nëpunësve të mbetur pas ristrukturimit që plotësojnë kërkesat e veçanta dhe të përgjithshme për pozicionin e ri të punës sipas përshkrimeve të reja*), janë kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave, si dhe Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimt nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave dhe konkretisht:

- Përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e përgjithëshme e të veçanta të këtyre pozicioneve dhe verifikimi i përputhshmërisë së tyre me karakteristikat personale të nëpunësve që janë riemëruar aktualisht në këto pozicione.
- Nëpunësit e riemëruar pas procesit të ristrukturimit, sipas Vendimit nr.29, datë 30.01.2015, “Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Elbasan”, të Këshillit të Qarkut Elbasan, gëzojnë apo jo statusin e nëpunësit civil dhe a plotësojnë apo jo kërkesat e përgjithëshme e të veçanta për pozicionin e punës sipas përshkrimeve të reja.

1/a Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Elbasan para procesit të ristrukturimit.

Nga tërësia e materialeve shkresore të vëna në dispozicion, nga verifikimi i tyre dhe ballafaqimi me ligjin rezultoi se:

Sipas strukturës së mëparshme, të miratuar me Vendimin nr. 23, datë 24.01.2014, “Për miratimin e Strukturës të Administratës së Qarkut Elbasan”, të Këshillit të Qarkut Elbasan, numri i përgjithshëm ishte **85** punonjës, nga të cilët **64** pozicione përfshiheshin në fushën e veprimit të ligjit për shërbimin civil dhe struktura e aparatit administrativ të institucionit kishte organizimin e mëposhtëm :

I. Drejtorja e Përgjithëshme e Koordinimit, Zhvillimit dhe Hartimit të Projekteve, me organikë **1 Drejtor të Përgjithshëm**, në përbërje të së cilës janë **2** Drejtori e konkretisht:

1-Drejtorja e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjisë Rajonale, me organikë **1 Drejtor dhe 6 specialistë**, gjithsej **7** pozicione pune në shërbimin civil.

2-Drejtorja e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë, me organikë **1 Drejtor dhe 5 specialistë**, gjithsej **6** pozicione pune në shërbimin civil.

II. Drejtoria e Përgjithshme e Edukimit, Informacionit dhe Përkujdesit Social, me organikë **1 Drejtor të Përgjithshëm**, në përbërje të së cilës janë **2 Drejtor** e konkretisht:

1-Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Marrëdhënieve me Jashtë dhe OJF, me organikë **1 Drejtor** dhe **4 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune në shërbimin civil.

2-Drejtoria e Shërbimeve të Përkujdesit Social, me organikë **1 Drejtor** dhe **4 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune në shërbimin civil.

III. Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Kontrollit, Zhvillimit të Territorit dhe Mbrojtjes së Tokës, me organikë **1 Drejtor të Përgjithshëm**, në përbërje të së cilës janë **1 Drejtor** dhe **1 Inspektoriat** e konkretisht:

1-Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit me organikë **1 Drejtor** dhe **6 specialistë**, gjithsej **7** pozicione pune në shërbimin civil.

2-Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës në Qark me organikë **1 Kryeinspektor** dhe **3 inspektor-specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune në shërbimin civil.

IV. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, me organikë **1 Drejtor i Përgjithshëm**, në përbërje të së cilës janë **4 Drejtor** e konkretisht:

1-Drejtoria e Financë-Buxhetit me organikë **1 Drejtor** dhe **3 specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune në shërbimin civil.

2-Drejtoria e Shërbimeve Juridike me organikë **1 Drejtor** dhe **4 specialistë**, gjithsej **5** pozicione pune në shërbimin civil.

3-Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave me organikë **1 Drejtor** dhe **5 specialistë**, gjithsej **6** pozicione pune në shërbimin civil.

4-Drejtoria e Burimeve Njerëzore me organikë **1 Drejtor** dhe **3 specialistë**, gjithsej **4** pozicione pune në shërbimin civil.

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark (funksion i deleguar), me organikë **1 Drejtor**, **4 përgjegjës** dhe **2 specialistë**, gjithsej **7** pozicione pune në shërbimin civil.

Sa më sipër rezulton se numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë është **64** (gjashtdhjetekatër), nga të cilët:

- **13** (trembëdhjetë) Drejtorë të Përgjithshëm dhe Drejtorë Drejtorie (nëpunës civilë të kategorisë së mesme drejtuese) ;
- **1** (një) përgjegjës sektori (nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues);
- **50** (pesëdhjetë) specialistë (nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive).

1/b Struktura organizative e Këshillit të Qarkut Elbasan pas procesit të ristrukturimit, miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan.

Sipas Vendimit nr.29, datë 30.01.2015, “Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Elbasan”, që është në fuqi në momentin e inspektimit të përgjithshëm, administrata e Këshillit të Qarkut Elbasan ka gjithsej **48** pozicione pune, nga të cilët **38** pozicione pune në shërbimin civil. Struktura është e organizuar si më poshtë:

1. Drejtoria Koordinim - Zhvillimit, me organikë **1** (një) **Drejtor** dhe **5** (pesë) **specialistë**, gjithsej **6** nëpunës civil;

2. Drejtoria e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social, me organikë **1** (një) **Drejtor** dhe **5** (pesë) **specialistë**, gjithsej **6** nëpunës civilë;

3. **Drejtoria e Shërbimit të Fëmijëve Autikë dhe Aftësive të Kufizuara**, me organikë 1 (një) **Drejtor** dhe 1 (një) **specialist**, gjithsej 2 nëpunës civilë.
4. **Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit**, me organikë 1 (një) **Drejtor** dhe 4 (katër) **specialistë**, gjithsej 5 nëpunës civilë.
5. **Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Juridike**, me organikë 1 (një) **Drejtor** dhe 4 (katër) **specialistë**, gjithsej 5 nëpunës civilë.
6. **Drejtoria e Financë Buxhetit**, me organikë 1 (një) **Drejtor** dhe 3 (tre) **specialistë**, gjithsej 4 nëpunës civilë.
7. **Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse**, me organikë 1 (një) **Drejtor** dhe 1 (një) **specialist**, gjithsej 2 nëpunës civilë.
8. **Inspektoriat i Mbrojtjes së Tokës**, me organikë 1 (një) inspektor specialist dhe **Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qark** (*funksion i deleguar*), me organikë 1 **Drejtor**, 4 **përgjegjës** dhe 2 **specialistë**, gjithsej 7 pozicione pune që përfshihen në shërbimin civil.

Sa më sipër, rezulton se, me miratimin e strukturës së re me Vendimin nr. 29, datë 30.01.2015, "Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Elbasan", në këtë institucion janë **38** (tridhjetetë) **pozicione pune**, nga të cilët:

- **7** (shtatë) **Drejtor Drejtorie**, nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues;
- **1** (një) **përgjegjës sektori** (*nëpunës civil i nivelit të ulët drejtues*); pozicione specialist, nëpunës civil të kategorisë ekzekutive;
- **30** (tridhjetë) **specialistë**, nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive;

Nga krahasimi i strukturave arrihet në konkluzionin se institucioni, Këshilli i Qarkut Elbasan ka kaluar një proces ristrukturimi (*konstatohet plotësimi i dy kërkesave ligjore për të pasur një proces ristrukturimi: shkurtimi i numrit të përgjithshëm të nëpunësve civilë dhe ndryshimi i strukturës organizative*). Në strukturën aktuale nuk ekzistojnë si njësi organizative **4** (katër) **Drejtori të Përgjithshme** dhe është shkurtuar numri i përgjithshëm i nëpunësve civilë nga **64** (*gjashtëdhjetekatër*) që ishin me strukturën e mëparshme, me strukturën aktuale janë efektive vetëm **38** (*tridhjetetë*) nëpunës.

- *Gjendja e respektimit të kërkesave ligjore për përshkrimin e punës.*

Sipas parashikimeve të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura", të Këshillit të Ministrave, është njësia përgjegjëse ajo që drejton gjithë procesin nga ana ligjore. Ajo përcakton kriteret e vendeve të reja të punës pas ristrukturimit dhe krijon komisionin e ristrukturimit, i cili shqyrton mundësitë e sistemimit të çdo nëpunësi civil në vendet e lira ekzistuese. Komisioni i ristrukturimit i propozon me shkrim njësia përgjegjëse transferimin e nëpunësit dhe e mbështet propozimin e tij mbi kriteret specifike të vendeve të lira apo të krijuara të reja si pasojë e ristrukturimit dhe të dhënat e nëpunësve civilë. Pas kësaj procedure, është njësia përgjegjëse, e cila ka detyrimin ligjor për marrjen e vendimit përfundimtar për lirin nga shërbimi civil të nëpunësve që u është shkurtuar

pozicioni i punës dhe u ka ndryshuar përshkrimi i punës, pas propozimit të bërë nga komisioni i ristrukturimit.

Përshkrimet e reja të punës i kanë paraprirë procesit të ristrukturimit. Sipas pikës 14 “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*”, të Vendimit nr. 142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimit nr.32, datë 30.01.2015, “*Për disa shtesa e ndryshime në Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Qarkut Elbasan*”, përshkrimet e reja të punës janë diktuar nga ndryshimi i mënyrës së organizimit të Këshillit të Qarkut Elbasan, si pasojë e ristrukturimit dhe janë një përmbledhje e misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore të pozicionit të punës, për shkak se duhet vlerësuar pozicioni i punës në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja. Një numër më i reduktuar nëpunësish civilë do të plotësojnë gjithë detyrimet në funksion të arritjes së misionit për të cilin është krijuar institucioni i këshillit të qarkut. Pra, **38** nëpunësit e emëruar, pas procesit të ristrukturimit, do të realizojnë detyrat që më parë i kanë realizuar **64** nëpunës civilë e, për rrjedhojë, përzgjedhja e tyre duhej bërë mbi bazën e kërkesave për një nivel më të lartë profesional, me aftësi të mira organizative dhe menaxhuese, si dhe përvojën e duhur për zgjidhjen e problemeve.

Këto rezultojnë se kanë qenë kriteret që janë mbajtur parasysh nga komisioni i ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse në marrjen e vendimeve përfundimtare të emërimit në pozicionet e mbetura pas procesit të ristrukturimit.

- *Respektimi i kërkesave ligjore për zbatimin e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, ”Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Vendimit nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave.*

Drejtuesi i njësisë organizative përgjegjëse të Këshillit të Qarkut Elbasan, ka hartuar përshkrimet e punës bazuar në Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu IV, “*Procedura dhe formati i përshkrimit të punës*” në funksion të procesit të ristrukturimit dhe në zbatim të Vendimit nr.29, datë 30.01.2015, “*Për miartimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015*”.

Përshkrimet e reja të punës janë bërë duke riklasifikuar pozicionet e mbetura në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e reja dhe janë një përmbledhje e misionit dhe qëllimit të përgjithshëm të Këshillit të Qarkut.

Konstatohet se, në tërësi, i gjithë procesi i ristrukturimit është kryer në përputhje me ligjin. Vendimet e lirim, si dhe riemërimit të nëpunësve civilë aktualë, janë hartuar në përputhje me nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave. Më konkretisht:

III. Procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të riemërimit në shërbimin civil të nëpunësve pas ristrukturimit të institucionit, komenti ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me Urdhrin nr.144, datë 31.12.2014, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Elbasan, “Për krijimin e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, dalë në bazë e për zbatim të Vendimit nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, “Për miratimin e strukturës organizative të Administratës së Këshillit të Qarkut Elbasan për vitin 2015”, nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimit nr.3, datë 14.04.2014, “Për krijimin, funksionimin dhe kompetencat e komisionit të ristrukturimit për shkak të mbylljes apo ristrukturimit”, të Departamentit të Administratës Publike, është krijuar Komisioni i Ristrukturimit.

Komisioni i Ristrukturimit, pasi ka përmbushur detyrimet ligjore të përcaktuara në pikën 3, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Vendimin nr.171, dt. 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave, ka bërë propozimet përkatëse para njësisë së personelit për sistemimin në punë të punonjësve më të përshtatshëm.

Për këtë është mbajtur si kriter thelbësor fakti që, gjithë kompetencat dhe funksionet e Këshillit të Qarkut do të ushtrohen nga një numër më i vogël punonjësish. Kjo situatë ka diktuar shkrirjen e drejtorive të përgjithshme, uljen e nivelit dhe kategorive të vendeve të punës dhe bashkimin e disa funksioneve të mëparshme në një pozicion pune.

Kjo ka sjellë si pasojë edhe konkluzionin e Komisionit të Ristrukturimit, që pas ristrukturimit, në punë do të mbaheshin punonjësit më të kualifikuar dhe më me eksperiencë (kriter ka qenë vlerësimi vjetor, vjetërsia në pozicionin aktual), në mënyrë që të ishin të aftë të përshtateshin me gjendjen e re të punëve, ku një nëpunës i vetëm duhej të përballonte punën e disa nëpunësve, sipas strukturës së mëparshme.

Po kështu, Komisioni i Ristrukturimit, me anë të procesverbalit nr. 1926/2, datë 31.01.2015, drejtuar njësisë përgjegjëse (Njësisë së Burimeve Njerëzore), bazuar në pikën 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, i ka propozuar kësaj të fundit Vendimin nr.1, datë 31.01.2015, “Për emërimin e nëpunësve civilë në pozicione të lira ekzistuese”; Vendimin nr.2, “Për lirim nga detyra të nëpunësve civilë” dhe Vendimin nr.3, datë 31.01.2015, “Për transferimin e punonjësve në ndërrmarrjet vartëse të Këshillit të Qarkut Elbasan”.

Këto vendime janë marrë pasi Komisioni i Ristrukturimit ka shqyrtuar dokumentacionin e nevojshëm ligjor (dosjen personale), përshkrimet e punës të pozicioneve të ristrukturuara, kriteret specifike të vendeve të lira të krijuara, vlerësimin vjetor dhe vjetërsinë në punë të secilit nëpunës. Nisur nga gjithë sa u tha më sipër, njësia e personelit ka pranuar

propozimet e Komisionit të Ristrukturimit dhe ka nxjerrë aktet e riemërimit pas ristrukturimit.

Konkluzion: Konstatohet se, në rastin kur ka pasur ulje në detyrë të punonjësit, nuk është marrë mendimi i tij me shkrim për pranimin ose refuzimin e pozicionit të ofruar, siç përcaktohet në pikën 19 dhe 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”. Kjo parregullsi nuk e bën të pavlefshëm vendimin e emërimit, i cili i plotëson kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, Vendimit nr. 171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirim nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimit nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave.

• *Aktet e emërimit pas ristrukturimit të Këshillit të Qarkut Elbasan, sipas Vendimit nr.29, datë 30.01.2015, ” Mbi strukturën organizative të Këshillit të Qarkut Elbasan” .*

1. ***** , me aktin administrativ nr.58, datë 10.02.2015 është emëruar, në detyrën e Drejtorit të Koordinim-Zhvillimit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II b*). Më parë, nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Koordinim Zhvillimit dhe Hartimit të Projekteve (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.1182, datë 06.11.2007 dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.978/5, datë 05.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës dhe ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të përgjithshëm.

2. ***** , me aktin administrativ nr.65/8, datë 10.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistes për zhvillimin ekonomik dhe turizmin në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-b*). Më parë ka kryer të njëjtën detyrë (*emëruar me Vendimin nr.8, datë 23.02.2001 dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.978/8, datë 06.06.2014, kategoria III-b*). Kjo nëpunëse plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës, për më tepër e ka ushtruar dhe më parë këtë detyrë.

3. ***** , me aktin administrativ nr.57, datë 10.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistit për projekte teknike dhe mjedisin në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-b*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Hartimit të Projekteve Teknike (*emëruar me aktin administrativ nr.20, datë 09.03.2009 dhe akti i deklaramit të statusit të punësimit nr.978/16, datë 05.06.2014, kategoria III-b*); plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

4. *****, me aktin administrativ nr. 66, datë 10.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistes për zhvillimin rural në Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-b*). Më parë ka qenë nëpunëse civile në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike e cila është përfshirë në Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Hartimit të Projekteve Teknike (*emëruar me aktin administrativ nr.88, datë 25.05.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/11, datë 05.06.2014, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, mbi 3 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

5. *****, me aktin administrativ nr.57, datë 10.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistes për koordinimin e investimeve në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-b*). Më parë ka qenë nëpunëse civile në detyrën e specialistes për njësinë e të drejtave të fëmijëve në Drejtorinë e Shërbimeve të Përkujdesit Social (*emëruar me aktin administrativ nr.21, datë 11.04.2011 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/26, datë 05.06.2014, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

6. *****, me aktin administrativ nr. 65/9, datë 10.02.2015, është emëruar në detyrën e specialistit për bazën e të dhënave në Drejtorinë e Koordinim Zhvillimit (*nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, kategoria IV-b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale e cila është përfshirë në Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale (*emëruar me aktin administrativ nr.23, datë 01.02.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/12 datë 05.06.2014, kategoria IV-a*). Kjo nëpunëse plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca humane, mbi 2 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

7. *****, me aktin administrativ nr. 55, datë 10.02.2015 është emëruar në pozicionin Drejtor i Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II b*). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Edukimit, Informacionit, Përkujdesit Social (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.68, datë 10.09.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/59, datë 07.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

8. *****, me aktin administrativ nr.54, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për kulturën dhe informacionin në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në detyrën e Drejtorit të Kulturës, Arsimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe OJF në varësi të Drejtorisë së Përgjithme të Përkujdesit Social (*emëruar me aktin administrativ nr.13, datë 10.01.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/20, datë 09.06.2014, kategoria II-b*). Nëpunësja *****

plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca sociale, mbi 3 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

9. ***** , me aktin administrativ nr.51, datë. 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për arsimin në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Përkujdesit Social, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Koordinim-Zhvillimit, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së Shërbimeve dhe Përkujdesit Social (*emëruar me aktin administrativ nr.16, datë 17.02.2014 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/12, datë 05.06.2014, nëpunës civil në periudhë prove, kategoria IV-b*). Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore, fakulteti Histori Gjeografi*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

10. ***** , me aktin administrativ nr. 65/7, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për Marrëdhëniet me Jashtë dhe OJF në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Marrëdhëniet me Jashtë dhe OJF, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e Drejtorisë së mëparshme (*emëruar me aktin administrativ nr.59, datë 01.11.2002 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/21, datë 06.06.2014, nëpunës civil kategoria III-b*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore, Filologji, mbi 10 vjet punë*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

11. ***** , me aktin administrativ nr.52, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për njësitë e të drejtave të fëmijëve në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Shërbimeve dhe Përkujdesit Social, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e drejtorisë së mëparshme (*emëruar me aktin administrativ nr.65, datë 20.05.2008 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/27 datë 05.06.2014, nëpunës civil kategoria III-b*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore, Gjuhë e Huaj, mbi 5 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

12. ***** , me aktin administrativ nr.53, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për grupet në nevojë dhe shërbimin social në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë specialiste për arsimin në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Mardhënieve me Jashtë dhe OJF, në varësi të Drejtorisë së Përgjithme të Përkujdesit Social, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social. Kjo e fundit ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e drejtorisë së mëparshme (*emëruar me aktin administrativ nr. 58, datë 14.01.2010 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/24, datë 05.06.2014, nëpunës civil, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, Ekonomia dhe e Drejta, mbi 5 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

13. *****, me aktin administrativ nr. 61, datë 10.02.2015 është emëruar në pozicionin Drejtor i Shërbimit të Fëmijëve Autikë dhe Aftësive të Kufizuara (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në detyrën e Drejtorit të Shërbimeve dhe Përkujdesit Social në varësi të Drejtorisë së Përgjithme të Përkujdesit (*emëruar me aktin administrativ nr.18, datë 23.01.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/25, datë 05.06.2014, kategoria II-b*); plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca sociale, Dega psikologji shkollore; mbi 2 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Kjo nëpunëse ka pasur përparësi në emërim, pasi më parë ka ushtruar të njëjtat funksione.

14. *****, me aktin administrativ nr. 60, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për shërbimet e fëmijëve me aftësi të kufizuara në Drejtorinë e Shërbimit të Fëmijëve Autikë dhe Aftësive të Kufizuara (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë specialiste për shërbimet sociale në Drejtorinë e Përkujdesit Social në varësi të Drejtorisë së Përgjithme të Përkujdesit, e cila është përfshirë në Drejtorinë e Shërbimit të Fëmijëve Autikë dhe Aftësive të Kufizuara, e cila ka marrë dhe funksionet dhe detyrat e drejtorisë së mëparshme (*emëruar me aktin administrativ nr.109, datë 14.08.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/29, datë 06.06.2014, nëpunës civil në periudhë prove, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca shoqërore, punonjës social*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

15. *****, me aktin administrativ nr. 46, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin Drejtor i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II b*). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr. 421, datë 08.03.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/30, datë 10.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca natyrore dega biologji-kimi, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës; ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të përgjithshëm.

16. *****, me aktin administrativ nr. 64, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për planifikimin e territorit në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë specialiste për regjistrin në të njëjtën drejtori, atë të Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit (*emëruar me aktin administrativ nr. 77, datë 17.04.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/34, datë 07.06.2014, nëpunës civil kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, Dega Inxhinieri Ndërtimi, mbi 3 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

17. *****, me aktin administrativ nr.63, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për kontrollin e territorit në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë specialiste për asistencë ligjore në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike (*emëruar me aktin administrativ nr.37, datë 25.02.2013 dhe akti i*

*deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/71, datë 09.06.2014, nëpunës civil kategoria IV-a). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (arsimi i lartë shkenca juridike, mbi 2 vjet përvojë pune) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.*

18. ***** , me aktin administrativ nr.65, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për mbrojtjen e mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë specialiste për regjistrin në të njëjtën drejtori (*emëruar me aktin administrativ nr.33, datë 21.02.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/35, datë 09.06.2014, nëpunës civil, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, Inxhinieri Ndërtimi, mbi 2 vjet përvojë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

19. ***** , me aktin administrativ nr.62, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për administrimin e regjistrit “GIS” në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësi ka konkuruar për pozicionin e specialistit të mjedisit në Drejtorinë e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, i cili rezultonte i paplotësuar për shkak të përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil (*plotësimi i moshës për pension të plotë pleqërie të nëpunësës civile ******). Nëpunësi civil ***** është emëruar me aktin administrativ nr.140, datë 22.12.2014, si nëpunës civil në periudhë prove; plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca inxhinierike, Dega Inxhinieri Ndërtimi*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

20. ***** , me aktin administrativ nr.47, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin Drejtor i Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II-b*). Më parë nëpunësi ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.67, datë 10.09.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/55, datë 09.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, Dega Inxhinieri Mekanike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës; ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar funksionet e drejtorit të përgjithshëm.

21. ***** , me aktin administrativ nr.65/10, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për shërbimet në njësitë vartëse në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a*). Më parë nëpunësi ka ushtruar të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.75, datë 08.09.2003 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/55, datë 09.06.2014*). Pas ristrukturimit funksionet e drejtorisë së mëparshme i ka marrë Drejtoria Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike; ka qenë me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimeve Mbështetëse (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.67, datë 10.09.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/56, datë 06.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, Dega Ekonomist për Industrinë, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

22. *****, me aktin administrativ nr.50, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për infrastrukturën dhe emergjencat në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-a*). Më parë nëpunësja ka ushtruar detyrën e specialistes për koordinimin e investimeve në Drejtorinë e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Koordinimit dhe Hartimit të Projekteve (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr. 98, datë 06.11.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/07, datë 05.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, Dega Inxhinieri Ndërtimi, mbi 5 vjet eksperiencë pune, vlerësime pozitive të dy viteve të fundit*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

23. *****, me aktin administrativ nr. 49, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për shërbimet juridike në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b*). Më parë nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse. Me miratimin e strukturës së re, funksionet e drejtorisë së mëparshme i ka marrë Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr. 6, datë 21.01.2003 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/68, datë 08.06.2014*). Nëpunësja plotëson kërkesat e posaçme sipas përshkrimit të ri të punës (*arsimi i lartë, Dega Drejtësi, mbi 5 vjet eksperiencë pune, vlerësime pozitive të dy viteve të fundit*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

24. *****, me aktin administrativ nr. 48, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste për shërbimet juridike në Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV-b*). Më parë nëpunësja ka ushtruar të njëjtën detyrë, por në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse. Me miratimin e strukturës së re funksionet e drejtorisë së mëparshme i ka marrë Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Shërbimeve Juridike (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr. 97, datë 03.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr. 978/70, datë 09.06.2014*). Nëpunësja plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë, Dega Drejtësi, mbi 5 vjet eksperiencë pune, vlerësime pozitive të dy viteve të fundit*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

25. *****, me aktin administrativ nr. 65/3, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin Drejtor i Financës dhe i Buxhetit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II- b*). Para ristrukturimit nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë, atë të Drejtorit të Financës dhe Buxhetit në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*emëruar me aktin administrativ nr.34, datë 21.02.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/62, datë 08.06.2014, kategoria II-b*); plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, Dega Administrim Publik; mbi 3 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

26. *****, me aktin administrativ nr.65/4, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për kontabilitetin dhe të ardhurat në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria IV-a*) Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë atë të specialistit për kontabilitetin dhe të ardhurat

në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*emëruar me aktin administrativ nr.821, datë 01.10.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/64, datë 09.06.2014, kategoria III-b*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike; mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

27. ***** , me aktin administrativ nr.65/5, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për buxhetin dhe shpenzimet në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria IV- a*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë atë të specialistit për buxhetin dhe shpenzimet në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*emëruar me aktin administrativ nr.8, datë 23.02.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/63, datë 08.06.2014, kategoria III-b*). Nëpunësja M.Qorri plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike; mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

28. ***** me aktin administrativ nr.65/6, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialist për menaxhimin financiar dhe kontrollin në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria IV- b*). Para ristrukturimit nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*emëruar me aktin administrativ nr.52, datë 19.03.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/65, datë 08.06.2014, kategoria IV-a*). Nëpunësja ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, Dega Financë Kontabilitet; mbi 3 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

29. ***** , me aktin administrativ nr.65/1, datë 10.02.2015 është emëruar në pozicionin Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (*nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, kategoria II- b*). Më parë nëpunësi ka qenë në të njëjtën detyrë (*Fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.68, datë 03.08.2010 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/72, datë 10.06.2014*). Nëpunësi plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, dega administrim biznes, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Nëpunësi në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar të njëjtat funksione.

30. ***** , me aktin administrativ nr.65/2, datë 10.02.2015, është emëruar në pozicionin specialiste e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria Iv-a*). Më parë nëpunësja ka qenë në të njëjtën detyrë specialiste e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.94, datë 30.06.2005 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/73, datë 10.06.2014*). Nëpunësja plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkenca ekonomike, mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës. Nëpunësja në fjalë ka pasur përparësi në emërim, për arsye se më parë ka ushtruar të njëjtat funksione.

31. ***** , është emëruar në pozicionin inspektor-specialist (*ulje në detyrë*) në Inspektoriatin e Mbrojtjes së Tokës (*nëpunës civil i nivelit ekzekutiv, kategoria IV- b*) Para

ristrukturimit nëpunësi ka ushtruar detyrën e Kryeinspektorit të Inspektoriatit e Mbrojtjes së Tokës (*emëruar me aktin administrativ nr.100, datë 13.11.2007 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/44, datë 09.06.2014, kategoria III-b*). Nëpunësi ***** plotëson kërkesat e posaçme (*arsimi i lartë shkencë inxhinierike, Dega Inxhinieri ndërtimi, profile inxhinier-gjeodet; mbi 5 vjet eksperiencë pune*) dhe të përgjithshme sipas formularit të përshkrimit të punës.

Konkluzion: Konstatohet se, bazuar në kompetencat ligjore të parashikuara në nenin 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimin nr.171 datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014, “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*”, të Këshillit të Ministrave, kriteret e ndjekura (*formularët e përshkrimit të punës*) nga komisioni i ristrukturimit dhe njësi përgjegjëse, në nxjerrjen e vendimit përfundimtar të emërimit kanë qenë në funksion të mënyrës së re të organizimit të Këshillit të Qarkut Elbasan si pasojë e ristrukturimit, realizimit të misionit, qëllimit të përgjithshëm, detyrave dhe përgjegjësi kryesore. Për këtë arsye, është vendosur që nëpunësit që janë mbajtur dhe riemëruar të kenë një nivel të lartë profesional, të kenë aftësi organizative, menaxhuese, të kenë përvojë në zgjidhjen e problemeve (*është konkluduar nga komisioni i ristrukturimit dhe njësi përgjegjëse që ish drejtorët e përgjithshëm të drejtojnë në funksionin e drejtorit të drejtorisë dhe të gjithë specialistët e riemëruar pas ristrukturimit të kryejnë të njëjtin funksion që kanë kryer dhe më parë*).

Riemërimet e nëpunësve civilë në pozicione të një kategorie të barabartë ose më të ulët janë bërë pa marrë paraprakisht deklarimin me shkrim të nëpunësit nëse pranon ose jo detyrën e re, siç përcaktohet në pikën 20, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*” .

Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun e Elbasanit **(Funksion i deleguar)**

32. ***** është riemëruar Drejtor i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Qarkun e Elbasanit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23, datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/48, datë 10.06.2014*).

33. ***** është riemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Zyrën e Qytetit të Peqinit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23/1, datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/52, datë 10.06.2014*).

34. ***** është riemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Zyrën e Qytetit të Librazhdit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23/2, datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/53, datë 10.06.2014*).

35. ***** është riemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Zyrën e Qytetit të Librazhdit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.23/3, datë 01.06.2001 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/47, datë 10.06.2014*).

36. ***** është riemëruar specialist-topograf i Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.22, datë 09.03.2009 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/50, datë 10.06.2014*).

37. ***** është riemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Zyrën e Qytetit të Elbasanit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.102, datë 18.07.2012 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/49, datë 10.06.2014*).

38. ***** është riemëruar inspektor-specialist i Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës në Zyrën e Qytetit të Gramshit (*fillimi i marrëdhënies së punës me aktin nr.17, datë 23.01.2013 dhe akti i deklarimit të statusit të punësimit nr.978/51, datë 10.06.2014*).

Konkluzion: Konstatohet se, për të gjithë nëpunësit civilë të Drejtorisë së Administrimit të Tokës në Qarkun e Elbasanit (funksion i deleguar), njësia përgjegjëse nuk ka nxjerrë aktet e emërimit pas procesit të ristrukturimit, detyrim ky i përcaktuar në nenin 50 e vijues të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, pavarësisht faktit që kjo njësi nuk ka pësuar ndryshim.

IV. Procedura ligjore e ndjekur nga njësia përgjegjëse e burimeve njerëzore në marrjen e vendimit përfundimtar të lirimit nga shërbimi civil i nëpunësve që iu është shkurtuar pozicioni i punës për shkak të ristrukturimit të institucionit, komentit ligjor dhe konkluzionet për secilin rast.

Me Vendimin nr. 2, datë 31.01.2015, të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Elbasan, “*Për lirimin nga detyra të nëpunësve civilë*”, Komisioni i Ristrukturimit, bazuar në kompetencat e parashikuara në nenin 50, pika 3, të ligjit nr.152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, i ka propozuar njësisë përgjegjëse nëpunësit që do të lirohen nga shërbimi civil në pamundësi sistemimi për shkak të shkurtimeve të pozicionit të punës dhe ndryshimit të kërkesave të posaçme të pozicionit të rikrijuar pas ristrukturimit. Nëpunësit të cilët janë propozuar për t’u liruar nga detyra për shkak të ristrukturimit të institucionit janë:

1. ***** ish nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, me detyrë Drejtor i Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale (*kategoria II-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.978/6, datë 05.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e mësipërm. Me vendimin nr.15, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit K.Çakalli nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale dhe as pozicioni i punonjësit. Funkcionet e drejtorisë së mësipërme dhe Drejtorisë së Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë në strukturën e re i kryen Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit.

2. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për shkrimin e projekteve në ish Drejtorinë e Kordinimit dhe Zbatimit të Strategjive Rajonale (*kategoria III b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/10, datë 05.06.2014, ***** e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr. 14, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit nga shërbimi civil, pasi në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Koordinimit dhe Zbatimit të Strategjive dhe as pozicioni i punonjësit. Funkcionet e drejtorisë së mësipërme dhe Drejtorisë së Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë në strukturën e re i kryen Drejtoria e Kordinim-Zhvillimit.

3. *****, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste për zhvillimin në ish Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/33, datë 05.06.2014, F.Biza e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr. 7, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i saj nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe as pozicioni i punonjësës (*është shkurtuar pozicioni i ish punonjësës, nga 5 specialistë, janë 4 nëpunës civilë*).

4. *****, ish nëpunës civil i nivelit të mesëm drejtues, me detyrë Drejtor i Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë (*kategoria II-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.978/13, datë 06.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e mësipërm. Me vendimin nr.13, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative nuk ekziston as Drejtoria e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë dhe as pozicioni i punonjësit. Funkcionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit.

5. *****, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste operatore në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/14, datë 06.06.2014, punonjësja e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.11, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse është vendosur lirimi i punonjësës nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë dhe as pozicioni i punonjësës. Funkcionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit.

6. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist operator në Drejtorinë e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.978/15, datë 06.06.2014, punonjësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.12, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit ***** nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Hartimit të Projekteve Teknike dhe Hartografisë dhe as pozicioni i punonjësit. Funkcionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Koordinim-Zhvillimit.

7. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i teknologjisë së informacionit në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*kategoria III-b*) Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/61, datë 09.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.10, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave dhe as pozicioni i punonjësit. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme dhe Drejtorisë së Shërbimeve Juridike në strukturën e re i kryen Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Juridike.

8. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist shërbimesh në ish Drejtorinë e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse (*kategoria III-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.978/58, datë 09.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.16, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit ***** nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Shërbimeve Rajonale dhe Emergjencave dhe as pozicioni i punonjësit. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Juridike.

9. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist për asistencë ligjore në Drejtorinë e Shërbimeve Juridike (*kategoria IV-a*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/69, datë 10.06.2014, nëpunësi e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.109, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit ***** nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston as Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe as pozicioni i punonjësit. Funkzionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Shërbimeve Rajonale, Emergjencave dhe Juridike.

10. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist jurist në ish Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*kategoria IV-a*). Aktin e çertifikimit të statusit nr.978/36, datë 09.06.2014, ky punonjës e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.08, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit ***** nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29 datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit dhe as pozicioni i punonjësit (*është shkurtuar pozicioni i nëpunësit, nga 5 specialistë, efektivë janë 4 nëpunës civilë*).

11. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*kategoria IV-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/47, datë 09.06.2014, ***** e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.17, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit

nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative nuk ekziston më Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës si njësi organizative dhe këtë funksion e kryen një inspektor në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (*është riemëruar ish kryeinspektori i IMT-së në Qark*).

12. *****, ish nëpunës civil i kategorisë ekzekutive, me detyrë specialist i Inspektoriatit të Mbrojtjes së Tokës në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit (*kategoria IV-b*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 978/46, datë 09.06.2014, e ka në pozicionin e sipërcituar. Me vendimin nr.18, datë 30.01.2015, të njësisë përgjegjëse, është vendosur lirimi i punonjësit nga shërbimi civil. Në strukturën e re organizative nuk ekziston më Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës si njësi organizative dhe këtë funksion e kryen një inspektor në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore (*është riemëruar ish kryeinspektori i IMT-së në Qark*).

13. *****, ish nëpunëse civile e kategorisë ekzekutive, me detyrë specialiste për kulturën në Drejtorinë e Kulturës, Arsimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe OJF-të në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Edukimit, Informacionit dhe Përkujdesit Social (*kategoria IV-a*). Aktin e çertifikimit të statusit nr. 890, datë 09.06.2014, nëpunësja e ka në pozicionin e mësipërm. Në strukturën e re organizative të miratuar me Vendimin nr.29, datë 30.01.2015, të Këshillit të Qarkut Elbasan, nuk ekziston Drejtoria e Kulturës, Arsimit, Marrëdhënieve me Jashtë dhe OJF-të në varësi administrative nga Drejtoria e Përgjithshme e Edukimit, Informacionit dhe Përkujdesit Social dhe as pozicioni i punonjëses. Funksionet e drejtorisë së mësipërme në strukturën e re i kryen Drejtoria e Edukimit, Kulturës dhe Përkujdesit Social.

Konkluzion : Konstatohet se, të gjithë aktet e lirimit të nxjerra nga njësi përgjegjëse kanë dalë në përputhje me kërkesat e nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimin nr.171, datë 26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave, Kreu III, “*Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit*” dhe Vendimin nr.142, datë 12.03.2014 “*Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura*” të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, nëpunësve të cilëve u është shkurtuar pozicioni i punës janë njoftuar 1 muaj përpara për fillimin e kësaj procedure dhe në përputhje me vjetërsinë i kanë dhënë të drejtën e dëmshpërblimit sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 50, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar; Vendimit nr.171, dt.26.03.2014, “*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*”, të Këshillit të Ministrave.

KONKLUZION:

Nisur nga parregullsitë e konstatuara, të cilat nuk cenojnë ligjshmërinë në tërësi të procesit, sepse mund të konsiderohen si të karakterit objektiv dhe që nuk kanë sjellë vendimmarrje të gabuar, lind domosdoshmëria e korigjimit të tyre në të ardhmen:

1. Njësia përgjegjëse të marrë vendimin përfundimtar të emërimit, në mënyrë nominale, për secilin nëpunës të Drejtorisë së Administrimit dhe Mbrojtjes së

Tokës sipas parashikimeve të nenit 50, pika 3, të ligjit 152/2013, ”Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil”, të Këshillit të Ministrave (të dalë akti individual i riemërimit të çdo nëpunësi të DAMT-së dhe ky të administrohet dhe të jetë pjesë e dosjes së personelit).

2. Njësia përgjegjëse të marrë mendimin me shkrim të gjithë nëpunësve të emëruar pas ristrukturimit sipas përcaktimeve të pikës 20, Kreu III, “Transferimi për shkak të mbylljes dhe ristrukturimit të institucionit”, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014, “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimimin nga shërbimi civil” dhe të administrojë atë në dosjen e personelit (dosje individuale).

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA